

Armela Krasniqi është zgjedhur Kryetare e Autoritetit të Mediave Audiovizive me vendim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, më 7 korrik 2021.

Gjithashtu, aktualisht është profesoreshë në Gazetari dhe Komunikim, në programet Bachelor dhe Master, në Universitetet e Prishtinës dhe Shqipërisë.

Armela Krasniqi u zgjodh Zëvendës Kryetare e EPRA-s në Takimin e 59-të të EPRA në Roterdam më 6 qershor 2024 dhe i bashkohet Bordit të EPRA-s për herë të parë, për një periudhë njëvjeçare.

Znj. Krasniqi mban gjithashtu pozitën e Kryetares së MNRA-së, e zgjedhur në Kuvendin e 22-të Plenar të kësaj organizate.

Gjatë karrierës së saj ajo u zgjodh anëtare e bordit ekzekutiv të EANA (Aleanca Evropiane e Agjencive të Lajmeve) në shtator 2019 deri në korrik 2021.

Një tjetër pozicion ndërkombëtar ishte zgjedhja si President i ABNA (Asociacioni i Agjencive Ballkanike të Lajmeve në Evropën Juglindore) në nëntor 2018.

Ajo ka një përvojë të konsiderueshme drejtuese në institucione të ndryshme publike dhe private në Shqipëri, si Drejtoresha e Përgjithshme e Agjencisë Shqiptare të Lajmeve; Drejtori i Përgjithshëm i Departamentit të Informimit dhe Marrëdhënieve me Publikun në Kryeministri; Drejtor i Departamentit të Lajmeve në Televizionin Publik; Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, televizionet private etj.

Znj. Krasniqi u diplomua në vitin 1999 në Fakultetin e Gazetarisë në Universitetin e Tiranës (Shqipëri). Ajo mban disa kualifikime nga Universiteti i Perugias, Presidenca e Umbria (Itali) në 2000 dhe Zyra e Kabinetit dhe Number 10 Londër (Mbretëria e Bashkuar) në 2016. Ajo ka të dhëna dhe ekspertizë me kompani ndërkombëtare si Price Water House dhe Coopers (PwC) 2020 – 2021.

Temat që lidhen me lirinë e medias, epokën dixhitale të medias, e ardhmja e gazetarisë dhe lufta kundër dezinformimit janë dhe çështjet kyçe për të cilat znj. Krasniqi ka më tepër kontribut.